



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.2/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e Gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN ndaj Gjyqtarës A.S., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarës të lartcekur në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës disiplinore, me dt. 15.02.2023, mori këtë:

A K T E V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për iniciim të procedurës disiplinore parashtruar nga ana e Rrjetit Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN kundër gjyqtarës A.S., Gjyqtarës në Gjykatën Themelore në Prizren.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren me dt. 17.01.2023 nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN ka pranuar kërkesë për iniciim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës A.S., gjyqtare në Departamentin për Krime të Rënda në Gjykatën Themelore në Prizren. Në kërkesë është cekur se në bazë të ligjit mbi përgjegjësinë disiplinore për Gjyqtar dhe prokuror është vlerësuar se gjyqtarja e lartcekur ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës si Gjyqtare gjatë trajtimit të dy çështjet penale P.nr.214/2012 dhe P.nr.32/2019 ku në dy rastet subjekt i procedurës penale ka qenë i pandehuri D.H.. Që të dy rastet janë gjykuar dhe kanë marrë formën e prerë. Pas analizës së këtyre rasteve BIRN konsideron se gjyqtarja ka shkelur dy pika për Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror, përkatësisht nenin 5 paragrafi 1.2 dhe nenin 5 paragrafi 2 nën paragrafi 2.15 të cilat parashohin shkeljet disiplinore si shkelje të ligjit dhe përfshirja në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës Themelore në Prizren pasi që ka pranuar Kërkesën e BIRN -it ka iniciuar hetimet për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim:

-Me datë 17.01.2023, nga arkiva e gjykatës janë siguruar shkresa të lëndës penale P.nr.214/2012 dhe P.nr.32/2019.

-Me date 17.01.2023 është iniciuar hetimi preliminar disiplinor sipas detyrës zyrtare ndaj Gjyqtarës A.S., dhe ne te njëjtën ditë është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për fillimin e hetimeve preliminare disiplinore në këtë çështje.

-Me datë 20.01.2023 i është dorëzuar Gjyqtarës A.S., Njoftimi mbi fillimin e hetimeve dhe është kërkuar që të deklarohet për te dy rastet te cilat i ka gjykuar P.nr.214/2012 dhe P.nr.32/2019.

-Gjyqtarja A.S., 23.012023 ka dorëzuar deklaratën me shkrim për rastin.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore ne Prizren pasi ka analizuar pretendimet ankimore dhe pas zhvillimit te procedurës preliminare hetimore ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore ne Prizren pas deklarimit te gjyqtares dine pas shqyrtimit dhe analizimit te shkresave te lëndës vlerëson se, sa i përket lëndës penale P.nr.214/12 nuk mund te iniciohen hetimet për procedurë disiplinore pasi ka ardhur deri te parashkrimi absolut për fillimin e hetimeve për shkeljet e pretenduara disiplinore. Nga koha kur pretendohet nxjerrja e Aktgjykimit P.nr.214/12 dt.01.10.2012 respektivisht kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore e deri me fillimin e hetimit disiplinor ndaj subjektit të lartcekur ka kaluar me tepër se dy (2) vite, ndërsa Ligji Nr.05/L-033 për Plotësimin Ndryshim të Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës si Njoftimi për përmasimin teknik ne Ligji Nr.05/L-033 për Plotësimin dhe ndryshimin te Ligjit Nr.03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, i cili ka qene ne fuqi ne kohën kur pretendohet se ka ndodhur shkelja disiplinore, me nenin 15 paragrafi I (5) kishte paraparë se procedura disiplinore nuk mund te filloj dhe te zhvillohet ne Komisionin Disiplinor pasi te kaloj afati nje (1) vjeçar nga njoftimi i pranuar ne Zyrën e Prokurorit Disiplinor për shkelje të supozuar dhe dy (2) vite nga dita e shkeljes se supozuar.

Pra, në rastin konkret kemi parashkrim te shkeljes së supozuar disiplinore ndaj gjyqtares A.S., Gjyqtare në Departamentin për Krime te Renda ne Gjykatën Themelore ne Prizren sa i përket lëndëve penale P.nr.214/12 te dt. 01. 10.2012.

Sa i përket lëndës penale P.nr.32/2019 te dt. 30.10.2020 gjatë hetimeve preliminare nga ana e Autoritetit Kompetent — Kryetarit te Gjykatës është konstatuar se gjyqtarja A.S., është ngarkuar me këtë lëndë me Aktakuzë te dt. 26.04.2019 ku si të akuzuar kane qenë katër të pandehur ne mes tyre edhe D.H., për verën penale vrasja e mbetur ne tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-se, te akuzuarit tjerë kanë qenë të akuzuar për vepra tjera penale. Gjyqtarja ka mbajtur disa shqyrtime Gjyqësore dhe ne shqyrtimin kryesor ne fjalën përfundimtare Prokurori i shtetit ka bërë ri cilësimin të aktakuzës ndaj të akuzuarit D.H., ashtu që nga vepra penale vrasja e mbetur ne tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK është ndryshuar në veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.5 lidhur me par. 1 pika 1.2 të KPK. Gjyqtarja e ka përfunduar shqyrtimin dhe shpallur fajtor te akuzuarin D.H.j (dhe të akuzuarit të tjerë) e ka dënuar me burgim ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili vendim me propozim te akuzuarit dhe mbrojtësit te tij e ne kuptim të nenit 44 te KPP është zëvendësuar me dënim me gjobë në vlerë prej 6000 (gjashtëmijë) në te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Ndaj këtij aktgjykimi, Prokurori i shtetit ka parashtruar ankesë ku Gjykata e Apelit me aktgjykim PAKR .nr. 10/2021 të dt. 19.02.2021 ka vërtetuar Aktgjykimin P.nr.32/2019 duke mos gjetur asnjë shkelje ligjore apo procedurale dhe kjo çështje ka marrë formën e prerë me vendimin e tyre. Pas plotfuqishmërisë lënda është ekzekutuar, është bërë pagesa e tërësishme dhe lënda është arkivuar.

Duke pasur parasysh se lënda penale P.nr.32/2019 është gjykuar, ka pasur ankesë dhe është vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit e cila ka pasur për detyrë që të verifikoj dhe të vendosi për

shkeljet dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të lartcekur dhe nuk ka gjetur se ka shkelje të ligjit ose shkelje procedurale konsiderojmë se në rastin konkret nuk janë përmbushur dispozitat nga shkeljet disiplinore për Gjyqtar[të paraparë nga neni 5 i Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gajtqarëve dhe prokurorëve nr. 06/1—057.

Nga të cekurat si më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD. GJ. Th. PZ – nr. 2/23 me datë 15.02.2023

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.

Kopja e vendimit dërgohet:

- Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese-BIRN.
- Gjyqtarës A.S.,